



Funded by  
the European Union



## THIRRJE PËR APLIKIM EKSPERTIZË NË NDËRMJETËSIM

**Projekti:** “Mbështetja e aksesit të qytetarëve në drejtësi nëpërmjet ndërmjetësimit në Shqipëri”.

**Qëllimi:** Nxitja e përdorimit të ndërmjetësimit në bashkëpunim me Qendrat e Ndhmës Juridike Falas dhe Gjykatat e Gjyroskastër dhe Lezhës (me fokus të veçantë grupet vulnerabël).

**Vendndodhja:** Lezha dhe Gjyroskastër.

**Numri ndërmjetësve që do të kontraktohen:** 2 (dy)

**Raportimi tek:** CSSP- Berlin Center for Integrative Mediation.

**Afati i fundit për aplikime:** E enjte 15 Gusht 2024 - 18:00 CET.

**Periudha e shërbimit:** 1 Shtator 2024 – 31 Gusht 2026.

### KUSH JEMI NE

**CSSP — Berlin Center for Integrative Mediation** është një organizatë jofitimprurëse me seli në Berlin, Gjermani dhe me zyra në Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë dhe Shqipëri. Ne kemi vepruar gjithashtu edhe në Maqedoninë e Veriut, Ukrainë, Egjipt dhe Nepal. CSSP është e pranishme në Shqipëri që nga viti 2018 për të zbatuar projektet më të rëndësishme në Sistemin e Ndërmjetësimit.

Që nga shkurti 2024, CSSP po zbaton projektin “*Mbështetja e aksesit të qytetarëve në drejtësi nëpërmjet ndërmjetësimit në Shqipëri*” i financuar nga Bashkimi Evropian, në partneritet me Qendrën e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI) dhe në bashkëpunim me Dhomen Kombëtare të Ndërmjetësve (DHKN) dhe Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas. Projekti synon të kontribuojë në përmirësimin e ndërtimit të kapaciteteve të ndërmjetësve, të mbështesë trajnimet e DHKN-së, të promovojë përdorimin e ndërmjetësimit të aktorëve të ndryshëm dhe të forcojë kapacitetet e ofruesve të ndihmës juridike falas për referimin e rasteve në ndërmjetësim.

**Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve** është një Ent Publik Juridik i pavarur, e cila ushtron veprimtarinë e saj në bazë të ligjit nr. 10385 datë 24.2.2011, i ndryshuar. DHKN rregullon dhe kontrollon ushtrimin e profesionit të ndërmjetësit, ofron trajnime vazhduese për ndërmjetësit dhe organizon trajnime fillestare me kandidatët për ndërmjetës.

**Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI)** është një organizatë jofitimprurëse dhe joqeveritare shqiptare, e cila aktualisht është e licencuar nga Ministria e Drejtësisë për të ofruar ndihmë juridike parësore falas. Që nga viti 2004, QSHPLI ka punuar për ofrimin e asistencës ligjore dhe psikologjike falas për grupet vulnerabël dhe zbatimin e drejtësisë restauruese për të miturit në Shqipëri.

**Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas (DNJF)** është në varësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe ka si mision të saj garantimin e aksesit të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë nëpërmjet



**Funded by  
the European Union**



ofrimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti. DNJF ofron shërbimin e saj në të gjithë Shqipërinë, që nga viti 2018.

Aktiviteti në këtë kërkesë për ofertë, është hartuar në bazë të kontratës së grantit “Veprimet e jashtme të Bashkimit Evropian – IPA III/2023/452-686”, nënshkruar ndërmjet CSSP – Berlin Center for Integrative Mediation dhe Bashkimit Evropian, i përfaqësuar nga Komisioni Evropian.

### **OBJEKTI SHËRBIMIT**

CSSP kërkon të kontrakttojë shërbimet e dy ndërmjetësve për 24 muaj në Gjirokastrë dhe Lezhë (një ndërmjetës për secilin qark), për të mbështetur referimin e rasteve në ndërmjetësim dhe për të rritur bashkëpunimin ndërmjet ndërmjetësve dhe Qendrave të Ndihmës Juridike Falas dhe Gjykatave. Këto dy qarqe janë ndikuar veçanërisht nga zbatimi i “hartës së re gjyqësore” në Shqipëri dhe aktualisht janë të pambuluar nga projekte të tjera në fushën e ndërmjetësimit. Çdo ndërmjetës do të ofrojë shërbime mesatarisht për 20 orë në javë. Dy ndërmjetësit do të raportojnë dhe do të ndërveprojnë në bashkëpunim të ngushtë me ekipin e projektit.

### **Ekspertiza përfshin shërbimet e mëposhtme:**

- Promovimi i ndërmjetësimit në qarkun e tij/saj, duke nxitur bashkëpunimin me Gjykatat, Qendrat e Ndihmës Juridike Falas, OJQ-të dhe autoritetet lokale për të rritur numrin e rasteve të referuara për ndërmjetësim.
- Organizimi takimeve të vazhdueshme me anëtarët e komunitetit për të dhënë informacion në lidhje me ndërmjetësimin dhe mënyrën e përfitimit nga ky shërbim, në zonën përkatëse.
- Realizimi takimeve të vazhdueshme me palët e interesuara veçanërisht me gjykatat e zonës përkatëse dhe drejtoritë vendore të ndihmës juridike falas, si dhe me aktorë të tjerë të drejtësisë për të promovuar ndërmjetësimin dhe referimin e çështjeve në ndërmjetësim.
- Të ndërmjetësojë me sukses të paktën 12 raste me palë grupe vulnerabël, duke siguruar dokumentet mbështetëse në përputhje me Projektin dhe rregulloret e BE-së (3 raste të përfunduara me sukses në 2024, 6 raste në 2025 dhe 3 raste në 2026).
- Bashkëpunim dhe lehtësim në organizimin e seminareve me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas dhe aktorë të tjerë përkatësisht në Lezhë dhe Gjirokastrë.
- Të përgatisë dhe të dorëzojë tek pala kontraktuese çdo muaj, një raport në lidhje me shërbimet e ofruara.

### **KRITERET E PRANIMIT DHE PROCESI I PËRZGJEDHJES**

Çdo aplikant në këtë thirrje do të përjashtohet automatikisht nëse ai/ajo ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme:

- Nuk ka reputacion të mirë në profesionin e tij/saj dhe/ose në rast se ka kryer ndonjë shkelje administrative ose ka ndonjë masë disiplinore në fuqi.
- Aktualisht është i punësuar në administratë publike.
- Në rast se kandidati ushtron aktivitetin e tij/saj të regjistruar, jashtë Qarkut Lezhë ose Gjirokastrë.
- Dokumentet e kërkuara në aplikim dhe/ose oferta financiare mungojnë.

*Njoftim përgjegjësie: Ky dokument është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e CSSP dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pozicionin e Bashkimit Evropian.*



Funded by  
the European Union



- Në rast se numri regjistrimit të aktivitetit nuk është aktiv ose është i pezulluar.

### Kriteret profesionale

Kërkojmë të kontraktujmë 2 ndërmjetës, të cilët kanë një zyrë në një nga qarqet përkatëse, që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të jetë ndërmjetës i licencuar prej të paktën 3 vitesh (15 pikë).
- Të ketë të paktën një vit eksperiencë pune me grupe vulnerabël dhe ta theksojë këtë përvojë në letrën e interesit (15 pikë).
- Eksperienca të mëparshme me qendrat e ndihmës juridike falas ose puna në ekipe multidisiplinare do të konsiderohet si avantazh (10 pikë)

### Kriteret ekonomike

- Oferta financiare (30 pikë)

Ne inkurajojmë shumë aplikimin e grave dhe profileve të ndryshme.

### SI TË APLIKONI

Ju lutem dërgoni aplikimin tuaj në gjuhën angleze ose shqipe dhe në formatin PDF në CSSP- Berlin Center for Integrative Mediation, email: [albania@cssp-mediation.org](mailto:albania@cssp-mediation.org) jo më vonë se data **15 gusht 2024**.

Aplikimi duhet të përfshijë:

- a) Një letër interesi, e cila duhet të tregojë qarkun specifik që doni të ofroni shërbimet tuaja, sipas kësaj thirrje. Kandidatët duhet të japin edhe të dhëna lidhur me kriteret profesionale të lartpërmendura.
- b) Një CV që përshkruan fushën tuaj specifike të ekspertizës.
- c) Deklaratë individuale për moskonflikt interesi me këtë pozicion shërbimi, ku deklarohet edhe mungesa e ndonjë mase administrative ose disiplinore nga kandidati.
- d) Një ofertë financiare që tregon vlerën totale të shërbimeve të kërkuara, për njësi mujore, në valutën EURO (përfshirë taksat dhe shpenzimet e mundshme)
- e) Një kopje të numrit të regjistrimit tatimor (NIPT).

**Shënim:** Dokumentet e aplikimit sipas pikave a), c) dhe d) duhet të dorëzohen të nënshkruara dhe të skanuara.

Shumë faleminderit për interesimin tuaj dhe kohën e investuar në aplikimin tuaj.

Tiranë me 26/07/2024



Funded by  
the European Union

